



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.944/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtuar nga Fidane Hasani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtuar nga Fidane Hasani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 11:25, ka pranuar një apel nga Fidane Hasani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë në të cilin thekson se në vendvotimet: 1105b/03R, 1105b/04R, 1105b/05R, 1105b/06R, 1101b/01R, 1101b/03R, 1101b/04R, 1112b/02R, 1112b/03R dhe 1122b/01R, i mungojnë votat e familjarëve dhe për këtë dyshon në keqpërdorim të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apelueses gjeti se, apeluesja nuk ka ofruar asnjë provë për të dëshmuar pretendimet e saj ankimore në lidhje me mungesën e votave. Prandaj Paneli apelin e saj e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat

ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.944/2017 me datën 12.11.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyhdi Haxhi**

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.